



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401351/15

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** *Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e çështjes së regjistrimit të titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 994, datë 09.12.2015, "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi".*

**Drejtuar :** **Nexhip Shullaku**  
Rregjistruese e Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

**POGRADEC**

**Për dijeni :** **Ministrisë së Drejtësisë**

**Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të pasurive të Paluajtshme**  
Z.Illirjan Muho

**F.C**  
Adresa:

**POGRADEC**

Z.Rregjistrues!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit F.C, në të cilën prezantohet shqetësimi për mosregjistrimin e titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, sipas të cilit rezultoi që familja bujqësore e ankuesit F.C. të jetë trajtuar me 2315m<sup>2</sup> tokë bujqësore në parcelën me numër 113/31, ZK 2420, e ndodhur në Fshatin Leshnicë, në vendin e quajtur "Kopaçe".

Për të mundësuar pajisjen me dokumente pronësie mbi pasurinë e lartpërmendur, ankuesi, rezultoi të ketë kryer aplikim pranë ZVRPP, Pogradec me nr.13, datë 05.01.2015. Në përgjigje të aplikimit ju jeni shprehur në Shkresën nr.3222/1 prot, datë

30.10.2015, drejtuar Kryeministrisë, Ministrisë së Drejtësisë, për këtë çështje, se, përcaktimet e kryera në Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi(AMTP)”, të Këshillit të Ministrave, pika 4, nuk lejojnë regjistrimin e titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, pa u plotësuar më parë kushtet e përcaktuara në këtë pikë.

Në kushtet kur Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013, është shfuqizuar sipas pikës 7 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015, nxjerrë nevojën e trajtimit të çështjes së regjistrimit të AMTP nr. 6381/R, datë 18.04.2005, që i përket familjes bujqësore të ankuesit F.C., sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 994, datë 09.12.2015, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.

Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit të punës, si dhe për një zgjidhje ligjore të këtij problemi çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresur se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës së ankuesit në fjalë.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

## **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e çështjes së regjistrimit të titullit të pronësisë, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 6381/R, datë 18.04.2005, të Komisionit të Ndarjes së Tokës të Komunës Çërravë, që i përket familjes bujqësore të ankuesit F.C., sipas përcaktimeve të kryera në VKM nr. 994, datë 09.12.2015, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.*

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi  
A.Gjoleka**